



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KAMËZ

DOKUMENTACIONI FISKAL I BIZNESIT TE VOGEL

Në zbatim të Ligjit Nr. 9632 datë 30. 10. 2006 “Për sistemimin e Taksave Vendore” me ndryshimet përkatse, Ligjit Nr. 9920, datë 19. 05. 2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit 665/1 Dt. 06. 02. 2007 në zbatim të tij, për çdo vendndodhje të veprimtarisë, tatimpaguesi duhet të mbajë një seri regjistrimesh më vete dhe dokumentacionin që lidhet me atë vendndodhje biznesi dhe pikërisht:

- **SUBJEKTET ME QARKULLIM VJETOR 0 – 2 MILION LEKE**

- a) **Dokumentet e blerjes** (fatura me TVSH, fatura të thjeshta, dëftesa tatimore)
- b) **Dokumentat e shitjes** (fatura të thjeshta tatimore, dëftesa tatimore dhe përmbledhëset ditore të arkës regjistruese për shitjet me arkë)
- c) **Librin e blerjeve**
- d) **Librin e shitjeve**

- **Tatim paguesi duhet të lëshoj për çdo shitje:**

- a) **Kupon Tatimor**, në rastin kur tatimpaguesi është i paisur me kasë regjistruese. Ky kupon i jepet klientit për çdo shitje të kryer.
- b) **Deftesa tatimore**, në rastin kur tatimpaguesi nuk është paisur me arkë regjistruese ose kur për arsye objektive, si mungesa e elektricitetit etj, tatimpaguesi nuk mund të përdorë arken regjistruese..
- c) **Fatur te thjeshtë tatimore**, lëshohet vetëm nga tatimpaguesit, të cilët shesin mallra apo shërbime për klient, të cilët nuk janë konsumator final të mallit apo shërbimit, por i kryejn këto blerje për qëllim përpunimi apo rishitje dhe janë objektive të rregjistruara për tatimet.

Këta tatimpagues ndryshe nga nënkategorit e tjera, nuk janë të detyruar të deklarojnë brenda 31 marsit të vitit tatimor pasues dhe të paguajnë tatimfitimin 10 % sipas ligjit të tatimit mbi të ardhurat.

Subjektet e biznesit të vogël me xhiro deri në 2 (dy) milion lekë duhen të paisen me Kasa Fiskale deri në muajn Qershor 2010.

- **SUBJEKTET ME QARKULLIM VJETOR 2 – 5 MILION LEKE**

Në zbatim të Ligjit Nr. 8438 Dt. 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet përkatse dhe Udhëzimin Nr. 1 Dt. 11. 01. 2008 “Për tatimin mbi të ardhurat” për çdo vendndodhje të veprimtarisë tatimpaguesi duhet të mbajë një seri regjistrimesh me vete dhe dokumentacionin që lidhet me atë vendndodhje biznesi.

- a) **Dokumentat e blerjes** (Faturë tatimore me TVSH, faturë e thjeshtë tatimore, dëftesa tatimore)
- b) **Dokumentat e shitjes** (Faturë e thjeshtë tatimore, dëftesë tatimore dhe përmbledhset ditore të arkës regjistruese për shitjet me arkë)
- c) **Librin e blerjeve**
- d) **Librin e shitjeve**
- e) **Librin e inventarit** (Gjendja e mallit në fund të vitit)

- f) **Librin e shpenzimeve dhe të ardhurave**
- g) **Librin e aktiveve të biznesit**

Tatimpaguesi duhet të lëshoj për cdo shitje:

- a) **Kupon tatimor**, në rastin kur tatimpaguesi është i paisur më kasë regjistruese. Ky kupon i jepet klientit për cdo shitje të kryer
- b) **Dëftesë tatimore**, në rastin kur tatimpaguesi nuk është paisur me arkë regjistruese ose kur për arsye objektive, si mungesa e elektricitetit etj, tatimpaguesi nuk mund të përdor arkë regjistruese.
- c) **Faturë të thjeshtë tatimore**, leshohet vetëm nga tatimpaguesit, të cilët shesin mallra apo shërbime për klient, të cilët nuk janë konsumator final të mallit apo shërbimit, por i kryen këto blerje për qëllim përpunimi apo rishitje dhe janë objekte të regjistruar për tatimet.

Këta tatimpagues janë të detyruar të deklarojnë brenda 31 marsit të vitit tatimor pasues (pranë Degës së Tatimeve të Tiranës) dhe ta paguajn tatimin mbi fitimin 10 % sipas Ligjit të tatimit mbi të ardhurat e cila është një pagesë për buxhetin e shtetit.

Subjektet e Biznesit të Vogël me xhiro 2 – 5 milion lekë duhen të paisen me kasa fiskale deri në muajin Qershor 2010.

- **SUBJEKTET ME QARKULLIM VJETOR 5 – 8 MILION LEKË**

Këta tatimpagues paraqesin një specifik të vecantë pasi janë biznes i vogël me TVSH. Kjo ka sjell si pasojë një situatë të ndërlikuar pasi subjekti duhet të paraqes deklaratat mujaore të TVSH-ës, pranë DRT dhe të parapaguj detyrimin për taksën vendore mbi BV pranë Bashkisë Kamëz. Shpeshherë mund të ndodh që qarkullimet të mos përputhen. Këta tatimpagues duhet të lëshojnë faturë tatimore me TVSH, dhe të gjithë librat e blerjeve, librin e shitjeve, librin e inventarit, librin e shpenzimeve dhe të ardhurave, librin e aktiveve të biznesit sipas regjistrimit fiskal të TVSH-ës.

Gjithashtu duhet të paisen me kasa fiskale 15 ditë nga data e kalimit me TVSH dhe jo sipas afateve të biznesit BV (Qershor 2010)

Këta tatimpagues janë të detyruar të deklarojnë brenda 31 Marsit të vitit tatimor pasues (pranë Degës së Tatimeve të Tiranës) dhe të paguajn tatimin mbi fitimin 10 % sipas Ligjit të Tatimit mbi të ardhurat e cila është një pagesë për buxhetin e shtetit.

- **SANKSIONET LIGJORE**

Në bazë të Ligjit. 9632, datë 30. 10. 2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, me ndryshimet, Ligjit. Nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, mosmbajtja e dokumentacionit fiskal përmban kundrvajtje administrative dhe ka sanksionet e mëposhtme:

1. **Mosafishimi ose mosparaqitja e certifikatës së regjistrimit (5.000 lekë)**
2. **Mosrespektimi i detyrimit për regjistrim apo detyrimit për përditësimin e të dhënave 25.000 lekë, (neni 112)**
3. **Mospagesa e detyrimit brenda afatit të parashikuar në Ligjë 5 % e shumës së detyrimit për cdo muaj, por jo më shumë se 25 % e detyrimit. (neni 114)**
4. **Fshehja e detyrimit tatimor (evizioni fiskal) nëpërmjet dokumentave, informacioneve apo deklaratave joreale dënohet me 100 % të diferencës së shumës së përlllogaritur nga ajo që duhej paguar në faktë. (neni 116)**
5. **Mosmbajtja e regjistrave apo dokumentacionit tatimor 10.000 lekë për cdo shkelje (neni 118)**
6. **Kryerja me lekë në dorë e transaksioneve të shitëblerjes me vlerë mbi 300.000 lekë (10 % e vlerës së transaksionit), (neni 120).**
7. **Mbajtje, përdorim apo transportim i mallit të pashoqëruar me dokumente tatimor dënohet me konfiskim të të gjithë sasisë së mallit ose pagesë në vend të vlerës së mallit. (neni 121)**

8. Mos instalimi i paisjeve fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë (neni 122).

- i. Herën e parë të konstatimit të mos instalimit të paisjes fiskale për të cilën është përcaktuar një afat vendosjeje deri me 10 ditë punë, me gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- ii. Herën e dytë të konstatimit të mos instalimit të paisjes fiskale pas mos respektimit të afatit të parë 10 ditore dhe kur për këtë paisje është përcaktuar një afat vendosjeje tjetër deri në 10 ditë, pas vendosjes së gjobës së parë, sipas ndarjes “i” të shkronjës “a” të kësaj pike, me gjobë në masën 500.000 (pesqindë mijë) lekë.
- iii. Pas kësaj perjudhe sipas ndarjes së shkronjës “a” të kësaj pike, me pezullim të veprimtarisë deri më 6 muaj:
- iv. Në rastet e mosvendosjes së paisjes fiskale me mbyllje të plotë të veprimtarisë.
- v. Nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo shërbimeve për cdo rastë.
- vi. Për herën e parë me gjobën më masën 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- vii. Për herën e dytë me gjobë me masën 500.000 (pesqindë mijë) lekë.
- viii. Për herën e tretë, me mbylljen e veprimtarisë për 6 muaj.
- ix. Lëshon një biletë që nuk përmban elementët e përcaktuara në këtë Ligjë për kuponin tatimorë, me gjobë në masën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.
- x. Nuk afishon në një vend të dukshëm një poster që tregon detyrimin e blersit të mallrave apo të përfituesit të shërbimit për të kërkuar kupon tatimor, me gjobë në masën 20.000 (njëzetë mijë) lekë.
- xi. Nuk mbanë kontrollin e gjurmës së kuponit tatimorë në mjedisin e ofrimit të mallrave apo shërbimeve me gjobë në masën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.
- xii. Nuk bën faturë për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve të ofruara, me dënim, sipas përcaktimeve të **nenit 124** të këtij ligji:
- xiii. Nuk mban libër llogarie për qarkullimin e mallrave, me dënim, sipas përcaktimeve të **nenit 118** të këtij ligji:
- xiv. Nuk merr me qqira apo nuk rregjistron paisje fiskale rezervë, në rastet kur ky ligjë e parashikon si detyrim, me gjobë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
- xv. Nuk mban dhe mirëmban në kushte pune paisjet fiskale, me gjobë në masën 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë.
- xvi. Nuk njofton menjëherë për defektin e ndodhur në paisjen fiskale dhe nuk plotëson në rregull librezën fiskale të defekteve, me gjobë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
- xvii. Moslëshimi i biletave të shërbimit me vlerë ta parashtypur të përdorura në sektor të ndryshëm, si transport, turizëm, artë, kulturë etj, dënohet me gjobë në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë për cdo biletë.
- xviii. Moslëshimi i faturës tatimore dënohet me 100 % të detyrimit të parapaguar apo padeklaruar (**neni 124**).
- xix. Shkelje për agjentët tatimor 50 % e shumës tatimit së plotë të tatimit të pambledhur apo të shmangur (**neni 117**).
- xx. Blerësi apo marrësi i shërbimit i cili nuk ka kupon tatimor 1.000 (një mijë) lekë (**neni 125**).
- xxi. Mos dhënja e informacionit të kërkuar nga administrata tatimore për 10.000 – 50.000 mijë lekë (**neni 126**).
- xxii. Pengimi në mënyrë të prejtëpërdrejtë apo të tërthortë i kontrollit apo hetimit tatimor 100.000 (njëqindë mijë) lekë (**neni 127**)
- xxiii. Lëshimi i faturës më TVSH nga tatimpaguesit të cilët nuk e kanë këtë të drejtë me 50 % të TVSH-ës së dhënë në faturën tatimore të paautorizuar dhe 100 % të asaj të faturuar padrejtësisht (**neni 128**)
- xxiv. Mos afishimi i cmimeve të shitjes 35.000 (tridhjetëepesë mijë) lekë (BV) dhe 65.000 (gjashtëdhjetë e pasë mijë) lekë (BM) (**neni 130**).